

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME



RAPORTI PËR VITIN 2024

MBI ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT

PËR IMPLEMENTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME 2023-2025

SHKUP, janar 2025

Përmbajtja

SHKURTESAT	3
HYRJE.....	4
MBI METODOLOGJINË DHE PROCESIN	6
TRAJNIME – Përforcimi i integritetit.....	6
KONTROLLET – Verifikimi i veprimit ligjor, profesional dhe etik	7
INDIKATORËT	9
PËRMBLEDHJE E MASAVE DHE AKTIVITETEVE TË NDËRMARRA NË VITIN 2024.....	11
QËLLIMI 1: Forcimi i integritetit për të reduktuar keqpërdorimin e pozitës dhe autoritetit zyrtar .	11
QËLLIMI 2: Forcimi i integritetit në policinë rrugore dhe kufitare për të reduktuar marrjen e ryshfetit.....	13
QËLLIMI 3: Forcimi i integritetit të punonjësve të policisë për zbatimin e ligjshëm të kompetencave policore	17
QËLLIMI 4: Forcimi i integritetit në zbatimin e prokurimeve publike.....	21
QËLLIMI 5: Reduktimi i rreziqeve në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore	23
QËLLIMI 6: Forcimi i integritetit individual dhe institucional për ruajtjen e imazhit të institucionit	23
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	25

SHKURTESAT

MPB – Ministria e punëve të brendshme

BSP – Byroja për siguri publike

DKBHKSP – Departamenti për kontrollin e brendshëm, hetimet kriminalistike dhe standardet profesionale

DÇPP – Departamenti për çështjet e përgjithshme dhe të përbashkëta

SPMK – Sektori për prokurime dhe menaxhimin e kontratave

DPPZS – Departamenti për prokurime publike dhe zbatimin e standardeve

DÇC – Departamenti për çështje civile

DÇA – Departamenti/ Njësia për çështje administrative

DÇLMBNJ – Departamenti për çështje ligjore dhe menaxhimin e burimeve njerëzore

DPU – Departamenti për polici të uniformuar

DPK – Departamenti për polici kriminalistike

DÇKM – Departamenti për çështje kufitare dhe migracion

NJKMK – Njësia për kontrollin kufitar dhe mbikëqyrjen kufitare

DÇPMBNJ – Departamenti për çështje të përbashkëta dhe menaxhimin e burimeve njerëzore

QR për ÇK – Qendrat rajonale për çështje kufitare

SP për KK dhe MK – Stacioni i policisë për kontrollin kufitar dhe mbikëqyrjen kufitare

SPB – Sektori për punë të brendshme

SP – JP – Stacioni i policisë me juridiksion të përgjithshëm

SP për STRR – Stacioni i policisë për sigurinë në trafikun rrugor

DP për STRR – Departamenti i policisë për sigurinë në trafikun rrugor

NJMSTRR – Njësia mobile për sigurinë në trafikun rrugor

NJEKTAP – Njësia për ekzaminime kriminalistike - teknike dhe analiza paraprake

PPU – Punonjës i policisë të uniformuar

PZA – Punonjës zyrtar i autorizuar

NJ.O. – Njësia organizative

QISMN – Qendra për integritetin në sektorin e mbrojtjes të Norvegjisë

HYRJE

Termi integritet, i shqyrtuar në nivelin e MPB-së, në masën më të madhe përfaqëson qëndrueshmërinë kundër korrupsionit, si dhe një përmbledhje të politikave, standardeve dhe procedurave të vendosura në Ministri, të cilat forcojnë qëndrueshmërinë kundër korrupsionit dhe zvogëlojnë rrezikun e veprimeve korruptive nga ana e punonjësve.

Kështu, integriteti mund të përkufizohet si mungesë e keqpërdorimit policor, respektim të Kodit Etik të Sjelljes, rregullave të përcaktuara, procedurave standarde dhe veprimit të punonjësve të policisë në përputhje me ligjet dhe aktet ligjore në fuqi. Integriteti i lartë policor është bazë për krijimin e respektit dhe besimit të ndërsjellë mes qytetarëve dhe policisë dhe luan një rol të madh në luftën efektive kundër krimit dhe korrupsionit.

Lufta kundër korrupsionit është përcaktuar si një nga prioritetet kryesore strategjike në Planin Strategjik të Ministrisë së Punëve të Brendshme 2024-2026 ku theksohet se në periudhën e ardhshme Ministria do të fokusohet në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të punës me qëllim forcimin e sundimit të ligjit përmes një luftë të paanshme kundër krimit të organizuar, korrupsionit, migracionit të paligjshëm, terrorizmit dhe kërcënimeve kibernetike.



Sfida kryesore për Ministrinë e punëve të brendshme si institucioni kyç për zbardhjen e rasteve të lidhura me korrupsionin si dhe parandalimin e tij, përfshinë identifikimin dhe detektimin në kohë të rreziqeve nga korrupsioni, si dhe zbardhjen, dokumentimin dhe argumentimin në kohë të sjelljeve korruptive në të cilat janë përfshirë punonjësit zyrtarë të autorizuar.



Qëllimi kryesor i Ministrisë së punëve të brendshme në luftën kundër korrupsionit është reduktimi i tij, ndërtimi i integritetit të punonjësve, ngritja e ndërgjegjësimit të punonjësve përmes trajnimeve adekuate, eliminimi i kushteve që mundësojnë prezencën e korrupsionit në polici dhe veprimi jo profesional, si dhe vendosja e standardeve etike të dëshiruara.

Ministria e punëve të brendshme, me luftën e saj proaktive kundër korrupsionit dhe mospranimin e tij në mënyrë absolute, ndërton mekanizma kontrolli, masa dhe aktivitete me qëllim ngushtimin e hapësirës për sjellje korruptive nga punonjësit e Ministrisë dhe Policisë, si dhe zbardhjen dhe ndëshkrimin e duhur të çdo rasti konkret.

Një nga këto mekanizma është Plani i Integritetit në MPB për periudhën 2023 - 2025 dhe plani përkatës i veprimit për zbatimin e tij, të hartuar me mbështetje nga Programi për reforma në sektorin e inteligjencës dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut (2021-2026), i cili zbatohet në bashkëpunim nga Ministria e punëve të brendshme dhe DCAF, Qendra e Gjenevës për Menaxhimin e Sektorit të Sigurisë.

MBI METODOLOGJINË DHE PROCESIN

Në kuadër të Planit të veprimit për zbatimin e Planit të integritetit të MPB-së 2023 – 2025, është parashikuar realizimi i trajnimeve në 5 (pesë) nga 6 (gjashtë) objektivat e përcaktuar.

Duke pasur parasysh se ky është tashmë viti i dytë i zbatimit të masave dhe aktiviteteve në kuadër të Planit të integritetit, pas hartimit dhe miratimit të Raportit për vitin e kaluar (2023), DKBHKSP ka filluar me përgatitjet dhe planifikimin e procesit metodologjik për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e veprimit për vitin 2024.

TRAJNIME – Përforcimi i integritetit

ОБУКА ЗА ПОЛИЦИСКИ ИНТЕГРИТЕТ

Дата и место, обучувачи

Нацрт – Агенда

- 10.00 – 10.30 Пристигнување / регистрација на учесници
- 10.30 – 11.15 Воведна сесија, модератор
 - претставување на учесниците
 - вовед во интегритет (презентација)
- 11.15 – 11.30 Пауза
- 11.30 – 12.15 Презентација од обучувачи за хибридни обуки
- 12.15 – 12.30 Пауза
- 12.30 – 13.15 Разработување на ризикот
 - презентација
 - дискусија
 - работа во групи
- 13.15 – 13.30 Завршна сесија
 - евалуација од учесниците
 - резиме на обуката

Integriteti policor ndërtohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, ndërsa vlerat dhe parimet në punën e pjesëtarëve të policisë duhet të jenë mënyra e punës.


Është e nevojshme që punonjësit e policisë të njohin parimet dhe vlerat mbi të cilat bazohet puna policore me qëllim që të përgatiten për një model bashkëkohor të punës policore, i cili nuk është vetëm ofrim i mbrojtjes për qytetarët, por edhe të pasurit kontroll mbi sjelljen.

Profesionalizmi, përgjegjësia dhe respektimi e zbatimi i ligjeve në fuqi janë themeli i integritetit policor.

Në këtë drejtim, DKBHKSP realizoi trajnimet e planifikuara duke ndjekur një agjendë të paracaktuar dhe duke trajtuar një sërë temash me interes për pjesëmarrësit.

Në kuadër të trajnimeve, u kushtua vëmendje e veçantë Kodit Etik dhe nivelit të informimit të pjesëmarrësve lidhur me dispozitat e tij. Gjatë secilit trajnim nga ana e DKBHKSP u theksua veçanërisht neni **16 i Kodit Etik**, konkretisht pika 5. Mos ushtrimi i veprimtarive që janë në konflikt me punët e brendshme ose detyrat policore.





Gjatë zhvillimit të trajnimeve, u theksua në veçanti inkurajimi i punonjësve që të kenë guximin të raportojnë veprimet e paligjshme dhe të tejkalojnë "murin blu të heshtjes"¹.

Pjesëmarrësit në trajnim u informuan se në DKBHKSP është siguruar një hapësirë e veçantë, një linjë telefonike dhe një adresë e-maili e veçantë për personin e autorizuar për pranimin e raportimeve nga sinjalizuesit.

<https://mvr.gov.mk/page/zakon-ukazuvaci>

KONTROLLET – Verifikimi i veprimit ligjor, profesional dhe etik

Në kuadër të Planit të veprimit është parashikuar kryerja e kontrolleve të brendshme nga DKBHKSP në katër (4) nga gjashtë (6) objektivat e përcaktuar.

OBJEKTIVI 1: FORCIMI I INTEGRITETIT ME QËLLIM QË Ë ZVOGËLOHET ABUZIMI ME POZITËN ZYRTARE DHE AUTORIZIMIN

Kontrolli ka të bëjë me:

- respektimin e orarit të punës në përputhje me orarin për punë
- realizimin e procesit të punës në dhomat për fotografim për qytetarët që kanë paraqitur kërkesë për lëshimin e dokumenteve personale
- verifikimin nëse personat që po fotografohen kanë një takim të caktuar paraprakisht
- kryerjen e testit të alkoolit për punonjësit e autorizuar për të cilët ka dyshime se janë nën ndikimin e alkoolit
- kontrollin e regjistrave të punës
- respektimin e nenit 168 pika 3 nga LPP, në lidhje me hapësirat zyrtare dhe mjetet motorike
- kontrollin e cilësisë në përmbushjen e detyrave të punës.

OBJEKTIVI 2: FORCIMI I INTEGRITETIT NË POLICINË RRUGORE DHE POLICINË E KUFIRIT ME QËLLIM ZVOGËLIMIN E MARRJEN E RYSHFETIT

Kontrolli ka të bëjë me:

- respektimin e orarit të punës në përputhje me orarin për punë
- respektimin e rregullave nga ana e punonjësve të uniformuar të policisë në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin në ambiente publike si restorante dhe objekte të tjera
- verifikimin e regjistrimeve në njësitet organizative në lidhje me numrin e ankesave nga ana e qytetarëve kundër punonjësve
- kryerjen e detyrave të përcaktuara në Urdhrat për kryerjen e shërbimit
- respektimin e Urdhrit për përdorimin e mjeteve motorike zyrtare

¹ Muri blu i heshtjes, gjithashtu kodi i kaltër dhe mburoja e kaltër janë terma që përdoren për të përshkruar një kod joformal heshtjeje mes punonjësve të policisë për të mos raportuar gabime, sjellje të papërshtatshme ose krime të kryera nga kolegët. Ky fenomen mund të krijojë një atmosferë të fshehtësie dhe të ndihmojë në mbulimin e veprimeve të papranueshme brenda forcave të rendit, duke penguar integritetin dhe profesionalizmin e institucioneve të policisë.

- kryerjen e testit të alkoolit për zyrtarët e uniformuar të policisë për të cilët ka dyshime se janë nën ndikimin e alkoolit
- kontrollin e regjistrave të punës dhe operativ
- respektimin e nenit 168 paragrafi 3 nga LPB, në lidhje me përdorimin e hapësirave dhe mjeteve motorike
- kontrollin e punonjësve të policisë në lidhje me zbatimin e detyrave të caktuara në urdhra dhe përdorimin SNKL (sistemi i ndjekjes dhe kontrollit të lëvizjes)
- kontrollin e cilësisë në përmbytjen e detyrave të punës
- kontrollin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve nga Plani i veprimit për implementimin e Planit të Integritetit të MPB-së 2023-2025

OBJEKTIVI 3: FORCIMI I INTEGRITETIT TË PUNONJËSVE TË POLICISË ME QËLLIM TË ZBATIMIT LIGJOR TË AUTORIZIMEVE POLICORE

Kontroli ka të bëjë me:

- respektimin e orarit të punës në përputhje me orarin për punë
- kontrollin e regjistrat për përdorimin e mjeteve të detyrimit, raportet e paraqitura dhe nëse janë përpiluar vlerësime për justifikimin e përdorimit të mjeteve të detyrimit, në përputhje me nenin 81, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë
- kontrollin e ankesave të paraqitura nga qytetarët dhe trajtimi i tyre, ose nëse trajtohen në përputhje me nenin 12, paragrafi 2 të Rregullores për kryerjen e punëve në DKBHKSP
- kontrollin e ankesave të paraqitura në SP, të dërguara në përputhje me nenin 6 të Rregullores për kryerjen e punëve në DKBHKSP
- kontrollin e regjistrave për personat e arrestuar, të privuar nga liria dhe të mbajtur, si dhe dosjet e përzgjedhura rastësisht të personave të cilëve u është kufizuar liria e lëvizjes
- kontrollin e ankesave dhe regjistrimeve për vepra penale për të cilat ndjekja është bërë në bazë të padisë private
- kryerjen e testit të alkoolit për zyrtarët e uniformuar të policisë për të cilët ka dyshime se janë nën ndikimin e alkoolit
- respektimin e nenit 168 paragrafi 3 nga LPB, në lidhje me përdorimin e hapësirave dhe mjeteve motorike

OBJEKTIVI 4: FORCIMI I INTEGRITETIT NË ZBATIMIN E PROKURIMEVE PUBLIKE

Kontroli ka të bëjë me:

- respektimin e orarit të punës
- respektimin e procesit të punës gjatë realizimit të prokurimeve publike, duke siguruar që ato të kryhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për sigurinë e informacioneve të klasifikuara dhe standardet e NATO-s për sigurinë e informacionit të klasifikuar
 - nëse po realizohen prokurimet publike në përputhje me planin e prokurimeve publike
 - cilat procedura të prokurimeve publike përdoren dhe cilat janë më shpesh të përdorura
 - nëse është përgatitur më parë një specifikim teknik nga organi që bën prokurimin
 - nëse ka më shumë se një procedurë prokurimi për një lloj prokurimi brenda vitit, respektivisht nëse ndahen prokurimet
- shikimin në disa çështje – kontrata, a bëhet prokurimi për gjithçka apo pjesërisht, a prokurohen artikujt me çmimet më të ulëta apo ka përjashtime, dhe nëse ka, çfarë është arsyeja

- nëse artikujt e klasifikuar si SEKRET SHTETËROR ruhen në kasaforta të mbyllura speciale, dhe
- respektimin e nenit 168 të Ligjit për punë të brendshme, që lidhet me hapësirat e shërbimit dhe mjetet motorike.

INDIKATORËT

Deri të gjitha njësitë organizative të përfshira në zbatimin e masave të përcaktuara në Planin e veprimit janë dërguar akte me të cilat është kërkuar nominimi dhe/ose ndryshimi i përfaqësuesve – koordinatorëve nga njësitë organizative përkatëse, si dhe informacion në raportet lidhur me statusin e indikatorëve që kanë të bëjnë me masat dhe aktivitetet e ndërmarra:

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE CIVILE

- janë realizuar 7 inspektime mbi ligjshmërinë në punë dhe mënyrën e trajtimit të palëve
- janë realizuar 7 inspektime për mbajtjen e distinktivëve.

DEPARTAMENTI PËR POLICI KRIMINALISTIKE

- mbajtja e "Trajnimit për punonjësit e policisë për respektimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore për zbatimin e autorizimeve policore".

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE TË PËRBASHKËTA DHE MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

- miratimi i akteve juridike në përputhje me ndryshimet e iniciuara
- publikimi i rregullt i shpalljeve publike për punësim në MPB – rritje e transparencës në procesin e punësimit në MPB,
- numër i zvogëluar i ankesave nga kandidatët e paraqitur në shpalljet publike e që nuk janë përzgjedhur, dhe
- numër i zvogëluar i ankesave nga kandidatët e paraqitur në shpalljet e brendshme për ngritje në detyrë e që nuk janë përzgjedhur.

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE LIGJORE DHE MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

- miratimi i akteve juridike në përputhje me ndryshimet e iniciuara
- publikimi i rregullt i shpalljeve publike për punësim në MPB – rritje e transparencës në procesin e punësimit në MPB,
- numër i zvogëluar i ankesave nga kandidatët e paraqitur në shpalljet publike e që nuk janë përzgjedhur, dhe
- numër i zvogëluar i ankesave nga kandidatët e paraqitur në shpalljet e brendshme për ngritje në detyrë e që nuk janë përzgjedhur.

SEKTORI PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

- është realizuar 1 auditim i brendshëm.

DEPARTAMENTI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN DHE ÇËSHTJE STRATEGJIKE

- portali në internet është përditësuar plotësisht me ligje dhe aktet nënligjore

QENDRA RAJONALE PËR ÇËSHTJE KUFITARE

- janë kryer 12 mbikëqyrje nga ana e drejtuesve

SEKTORI PËR PUNË TË BRENDSHME

- janë kryer 12 mbikëqyrje nga SPB
- janë kryer 12 mbikëqyrje nga ana e drejtuesve – SPB (DÇCM, DPU dhe QR për ÇK)

DEPARTAMENTI PËR POLICI TË UNIFORMUAR

- janë kryer 6 kontrolle nga ana e BSP – DPU (dhe DÇKM)
- janë realizuar 12 mbikëqyrje nga ana e drejtuesve – DPU (SPB, DÇKM dhe QR për ÇK)

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE KUFITARE DHE MIGRACION

- janë kryer 6 nga ana e BSP – DÇKM (dhe DPU)
- janë realizuar 12 mbikëqyrje nga ana e drejtuesve – DÇKM (SPB, DPU dhe QR për ÇK)

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE E PËRGJITHSHME DHE TË PËRBASHKËTA

- janë siguruar 10 kamera për video mbikëqyrje për nevojat e Departamentit për çështje civile
- janë siguruar 10 kamera trupore dhe 10 kamera për automjete (Objektivi 2)
- janë blerë 100 uniforma (Objektivi 2)
- janë siguruar 10 kamera trupore dhe 10 kamera për automjete (Objektivi 3)
- është kryer analiza e tregut për produkte dhe shërbime për një rast specifik
- është vendosur video mbikëqyrje në arkivin e dosjeve të formuara për prokurimet publike në DÇPP dhe janë vendosur dyer sigurie në hapësirat ku zhvillohet procedura e prokurimeve publike

PËRMBLEDHJE E MASAVE DHE AKTIVITETEVE TË NDËRMARRA NË
VITIN 2024

QËLLIMI 1: Forcimi i integritetit për të reduktuar keqpërdorimin e pozitës dhe autoritetit zyrtar

RREZIQET:

- 1. Favorizimi i palëve të caktuara gjatë lëshimit të dokumenteve personale, lejeve, licencave dhe certifikatave
- 2. Falsifikimi i dokumenteve personale dhe të tjera
- 3. Pranimi i parave nga qytetarët dhe kërkimi/pranimi i dhuratave, shërbimeve falas dhe përfitimeve të tjera

NJËSITË ORGANIZATIVE PËRGJEGJËSE:

- 1. Departamenti për çështje civile (DÇC)
- 2. Departamenti për kontroll të brendshëm, hetime kriminalistike dhe standarde profesionale (DKBHKSP)

NJËSITË TJERA ORGANIZATIVE PËRGJEGJËSE

- 1. Qendra për trajnime
- 2. Departamenti për çështje ligjore dhe menaxhimin e burimeve njerëzore
- 3. Ekspertë vendorë dhe të huaj nga fusha përkatëse

OBJEKTIVAT E INDIKATORIT PËR	OBJEKTIVAT E REALIZUAR TË INDIKATORIT PËR VITIN 2024
1. Dy trajnime për 20 të punësuar në DÇC	DKBHKSP: 1. 25.09.2024 , NJPB Prilep, trajnim për <u>22</u> punonjës zyrtarë të autorizuar nga SÇA Manastir 2. 02.10.2024 , SPB Shtip, trajnim për <u>14</u> punonjës zyrtarë të autorizuar nga SÇA Shtip
2. janë siguruar 10 kamera për video mbikëqyrje	DÇPP: Blerja është planifikuar të realizohet në vitin 2025, në përputhje me mundësitë buxhetore.
3. janë kryer 7 mbikëqyrje nga ana e DÇC për ligjshmërinë në punë dhe mënyrën e trajtimit të palëve	DÇC: Janë kryer gjithsej 14 kontrole mbikëqyrëse në njësitë rajonale të Departamentit (Seksionet për çështje administrative dhe Seksionet për armë, eksplozivë dhe lëndë të rrezikshme) – Shtip, Koçan, Vinicë, Sveti Nikollë, Probishtip, Strumicë, Gjevgjeli, Vallandovë, Radovish, Veles, Kavadar, Negotinë, Manastir
4. Janë realizuar 2 kontrole të brendshme në DÇC	DKBHKSP: 21.02.2024 r 1. Departamenti për çështje administrative – Shkup në objektin e RTVM, 2. Departamenti për çështje administrative – Shkup në objektin e SP – JP Kisela Voda (Prolet) dhe 3. Departamenti për çështje administrative – Shkup në objektin e SP - JP Qendër (Beko) <u>Gjetia</u> - nuk janë konstatuar parregullsi në punë - është vërtetuar se respektohet rendi dhe diciplina e punës

	- në sportelet për lëshimin e dokumenteve personale me procedurë urgjente funksionojnë të gjithë kompjuterët e parashikuar me kartat CAST - në mënyrë të rregullt dokumentet personale të përgatitura bashkohen me kërkesat dhe ato dorëzohen në kohë për lëshim për qytetarët 4. 02.10.2024 r. Departamenti për çështje administrative – Shtip në objektin e SPB Shtip <u>Gjetjet dhe masat</u> Sipas nenit 20, paragrafi 1, pika 7, të Rregullores së DKBHKSP, është dhënë një këshillë për punonjësit në Seksion që të mbajnë në mënyrë të rregullt dhe të saktë regjistrat me të cilët janë të ngarkuar në kuadër të pozicioneve të tyre.
5. Janë kryer 7 mbikëqyrje nga ana e DÇC për mbajtjen e distinktivëve	DÇC: - Departamenti vazhdimisht jep udhëzime për procedurat e veprimit për çdo Nj.O. nën juridiksionin e tij - një pjesë e punonjësve nuk kanë distinktivë ose ato janë të dëmtuar, DÇC në koordinim me DITK kanë dërguar kërkesë në DMPOC për përpunimin e kartelevë/distinktivëve

Në kuadër të këtij rreziku të identifikuar dhe objektivave të parashikuar të indikatorëve për vitin 2024, të cilët janë të matshëm, u konstatua si vijon:

- shkalla e realizimit të trajnimeve është arritur, janë paraparë dy trajnime dhe të dyja janë realizuar, me një ulje minimale të kuotës së pjesëmarrësve² (të paraparë 40 PZA, kanë marrë pjesë 36 PZA)

- shkalla e realizimit të mbikëqyrjeve mbi ligjshmërinë e punës është arritur plotësisht, madje është tejkaluar ndjeshëm, pra nga shtatë mbikëqyrje të parashikuara, janë kryer 14

- shkalla e parashikuar e realizimit të kontrolleve të brendshme është përmbushur dhe tejkaluar, janë kryer katër kontrolle, ku në shumicën prej tyre nuk janë konstatuar mangësi, përveç një rasti ku janë propozuar masa konkrete

- shkalla e realizimit të mbikëqyrjeve lidhur me mbajtjen e distinktivëve gjithashtu është arritur plotësisht, duke u konstatuar se një pjesë e të punësuarve nuk kanë distinktivë ose ato janë dëmtuar. Aktualisht, është në proces përgatitja dhe zëvendësimi i tyre në koordinim midis DÇC – DITK – DMPOC

Shënim: Krahasimi me objektivat e realizuar të indikatorëve në vitin 2023

1. numri i trajnimeve mbetet në të njëjtin nivel, me një ulje minimale të numrit të pjesëmarrësve

2. numri i mbikëqyrjeve është rritur ndjeshëm, duke siguruar që të punësuarit të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret

3. çështja me distinktivët ka qenë një problem edhe në vitin 2023, dhe është një çështje e natyrës teknike

² Gjatë kohës së realizimit të trajnimit, në njësinë organizative nuk kishte mjaftueshëm punonjës që mund të merrnin pjesë në trajnim, pasi ata duhej të qëndronin në vendet e tyre të punës për të siguruar respektimin e rregullit dhe procesit të punës

QËLLIMI 2: Forcimi i integritetit në policinë rrugore dhe kufitare për të reduktuar marrjen e rryshfetit

RREZIQET

- 1. Pranimi i mjeteve monetare nga qytetarët
- 2. Kërkimi dhe pranimi i dhuratave, shërbimeve falas dhe përfitimeve të tjera

NJËSITË ORGANIZATIVE PËRGJEGJËSE:

- 1. Departamenti i policisë së uniformuar (DPU)
- 2. Departamenti për çështje kufitare dhe migracione (DÇKM)
- 3. Departamenti për kontrollin e brendshëm, hetime kriminale dhe standarde profesionale (DKBHKSP)

NJËSITË TJERA ORGANIZATIVE PËRGJEGJËSE

- 1. Qendra për trajnime
- 2. Sektorët për punë të brendshme (SPB)
- 3. Ekspertë të fushës vendorë ose të huaj

OBJEKTIVAT E INDIKATORIT PËR VITIN 2024	OBJEKTIVAT E REALIZUAR TË INDIKATORIT PËR VITIN 2024
Dy trajnime për 40 të punësuar me temën: "Forcimi i integritetit të të punësuarve në policinë rrugore dhe në pikat kufitare"	1. MPB dhe partnerë të huaj (QISMN) – gjithsej 5 trajnime 1.1. 18.04.2024, MPB – Shkup, ndërtesa 6, trajnim për pjesëtarët DÇKM dhe QR për ÇK në pozita drejtuese 1.2. 28.05.2024, QR për ÇK Lindje – Dellçevë, trajnim për <u>17</u> punonjës në SP për KK dhe MK pranë QR për ÇK Lindje 1.3. 30.05.2024, QR për ÇK Perëndim – Ohër, trajnim për <u>22</u> punonjës në SP për KK dhe MK pranë QR për ÇK Perëndim 1.4. 04.06.2024, QR për ÇK Veri – Shkup, trajnim për <u>21</u> punonjës në SP për KK dhe MK pranë QR për ÇK Veri 1.5. 05.06.2024, QR për ÇK Jug – Kavadar, trajnim për <u>17</u> punonjës në SP për KK dhe MK pranë QR për ÇK Jug 2. MPB – gjithsej 2 2.1. 07.11.2024, PS për STRR Shtip, trajnim për <u>20</u> punonjës të policisë në SP për STRR Shtip 2.2. 18.12.2024, SPB Strumicë, trajnim për <u>21</u> punonjës të policisë në SP dhe DP për STRR pranë SPB Strumicë 3. SPB Ohër 3.1. 17.12.2024, trajnim për <u>19</u> punonjës të policisë nga policia e trafikut dhe me juridiksion të përgjithshëm pranë SPB Ohër
2.1 Janë kryer 12 kontrole nga ana e SPB 2.2 Janë kryer 6 kontrole nga ana e BSP (DPU, DÇCM)	SPB Shkup Janë kryer 52 kontrole në DSTRR – NJDTRR nga ana e stafit drejtues, nuk janë gjetur elemente për të ndërmarrë veprim dhe sanksionim SPB Kumanovë 90 mbikëqyrje kontrolluese SPB Tetovë 174 mbikëqyrje nga ana e DP, SP dhe DP të trafikut

	SPB Veles Kontrolle të rregullta sipas planeve mujore për shërbimet e kontrollit, si dhe kontrolle të jashtëzakonshme nga drejtuesit e drejtpërdrejtë mbi ZPU nga STRR SPB Shtip Të realizuar 81 kontrolle ndaj ZPU SPB Manastir 12 mbikëqyrje në pjesën e punës së policisë rrugore SPB Strumicë Kontrolle të rregullta sipas planit mujor SPB Ohër - 7 mbikëqyrje nga drejtuesit ndaj ZPU në lidhje me kamerat trupore - 164 mbikëqyrje dhe kontrolle nga drejtuesit e NJ.O. në pjesën e SP dhe DP për STRR dhe punën e punonjësve të policisë (PP) DPU: - SÇT (sektori për çështje të trafikut) ka kryer 70 shërbime kontrolluese dhe 2 mbikëqyrje të përgjithshme STRR (siguria e trafikut rrugor) - SÇT ka kryer 85 shërbime kontrolluese në NJMSTRR - SÇPJP (Sektori për çështje policore me juridiksion të përgjithshëm) ka kryer 18 shërbime kontrolluese në 70 SP dhe DP të JP DÇCM: - gjithsej 33 kontrolle nga ana e NJKKMK
3. Janë kryer 2 kontrolle të brendshëm në të gjithë stacionet/sektorët e trafikut dhe SP për KK dhe MK	1. 24.05.2024, SP për KK dhe MK Bogorodicë 2. 24.05.2024, SP për KK dhe MK Dojran 3. 24.05.2024, SP për KK dhe MK Mexhitlija 4. 24.05.2024, SP për KK dhe MK – Manastir 5. 24.05.2024, DP për STRR – Krushevë 6. 24.05.2024, SP për KK Bllacë e Poshtme Masa të detyrueshme - shefi i QR për ÇK Veri të ndërmarrë masa të duhura për tejkalimin e mangësive të konstatuara, pra të mbahet siç duhet Evidenca për ngjarjet ditore (formulari nr. 55) dhe Evidenca ditore për kilometrat e përshkuar - në të ardhmen, të vepohet plotësisht në përputhje me dispozitat e Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave të policisë dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të evidencave të policisë, dhe Rregullores për shpërndarjen, përdorimin, mirëmbajtjen dhe rinovimin e automjeteve të MPB-së. 7. 24.05.2024, SP për KK Tabanoc Masa të detyrueshme - shefi i QR për ÇK Veri të ndërmarrë masa të duhura për tejkalimin e mangësive të konstatuara, pra të mbahet siç duhet Evidenca për ngjarjet ditore (formulari nr. 55) dhe Evidenca ditore për kilometrat e përshkuar - në të ardhmen, të vepohet plotësisht në përputhje me dispozitat e Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave të policisë dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të evidencave të policisë, dhe

